

Pjesëmarrja në trajnimin “Auditimi i Sistemeve të Informacionit dhe Auditimi i e-Qeverisjes” në ICISA, Indi

Në kuadër të Programit të Bashkëpunimit Teknik dhe Ekonomik Indian, i qeverisë së Indisë, në datat 6-29 janar 2025, në Qendrën Ndërkombëtare për Sistemet e Informacionit dhe Auditimit (ICISA) në Noida, Indi, u zhvillua trajnimi ndërkombëtar “Auditimi i Sistemeve të Informacionit dhe Auditimi i e-Qeverisjes”. Në këtë aktivitet, Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua nga audituesja Klara Frangaj.

Programi i Bashkëpunimit Teknik dhe Ekonomik Indian (ITEC) ofroi një platformë unike ku pjesëmarrës nga vende të ndryshme ndajnë njohuritë dhe ndërtojnë aftësitë e nevojshme për auditimet e sistemeve të informacionit dhe temave të qeverisjes elektronike.

Qeveritë në mbarë botën përqafojnë teknologjitë dixhitale për t'i shërbyer më mirë qytetarëve të tyre dhe nevoja për auditime cilësore për të parandaluar keqpërdorimet, mashtrimet dhe gabimet bëhet parësore. Trajnimi 3-javor ndihmoi pjesëmarrësit për të fituar aftësi në vlerësimin dhe përmirësimin e strukturës së qeverisjes dixhitale, duke siguruar që ato të mbeten të sigurta, efikase dhe të besueshme.

Transformimi dixhital në sektorin publik është një proces i vazhdueshëm dhe roli i pjesëmarrësve si auditues dhe specialistë do të jetë vendimtar për të siguruar suksesin e tyre. SAI-it kanë një përgjegjësi për të siguruar që përfitimet e qeverisjes të arrijnë te qytetarët, të cilëve duhet t'u shërbejnë në mënyrë të drejtë dhe transparente.



Përfaqësuesja e Kontrollit të Lartë të Shtetit, znj. Klara Frangaj u përzgjedh për të mbajtur fjalimin në ceremoninë e shpërndarjes së certifikatave të trajnimit, duke përfaqësuar jo vetëm Shqipërinë, por të gjithë grupin e pjesëmarrësve ndërkombëtarë.

Gjatë qëndrimit në ICISA, shtetet pjesëmarrëse prezantuan dhe SAI-it përkatës jo vetëm nga ana institucionale lidhur me rolin dhe veprimtarinë audituese, por edhe nga pikëpamja kulturore dhe tradicionale.